




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Datë/a:	09.11.2021
Referenc-ë:	07-353/04-239990/21
Për/ Za/ To:	“American Hospital Kosova” SH.P.K
Përmes/Preko/Through:	Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
Nga/ Od/ From:	Punoji: Liridona Kastrati, zyrtare për hapësira publike
Tema/ Subjekat/Subject:	Kontrolloi: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit Pëlqim



Drejtorija për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim ka pranuar kërkesën me nr protokollit 07-353/04-239990/21 nga “American Hospital Kosova” SH.P.K me të cilën kërkohet shfrytëzimi i hapësirës publike dhe vendosja e një tende në Sheshin “Zahir Pajaziti” përball hotel Grandit me datë 14 Nëntor 2021 deri nga ora 09:00 deri në 18:00.

Qëllimi i kërkesës është shënimi i Ditës Botërore të Diabetit, gjithashtu qytetarët do të kenë mundësi të informohen rreth kësaj sëmundjeje si dhe shërbimet që mund ti marrin në Spitalin Amerikan me qëllim të parandalimit dhe luftimit të tij.

Drejtorija pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për “Vendosjen, Ndërtimin dhe Largimin e Objekteve të Përkohshme në Pronë Publike” me nr.01-110-157481, jep pëlqimin “American Hospital Kosova” SH.P.K për shfrytëzimin e hapësirës publike dhe vendosjen e një tende në sheshin “Zahir Pajaziti” përball hotel Grandit me datë 14 Nëntor 2021 nga ora 09:00 deri në 18:00 sipas kërkesës së parashtruar.

Kushtet e pëlqimit:

- Nuk lejohet dëmtimi i pronës publike dhe çdo dëmtim eventual si pasojë e këtij aktiviteti do të jetë përgjegjësi e juaja;
- Të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës për organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve publike;
- Varësisht nga vendimet e IKSHP-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi.

Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar.